REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
**KOMUNA –SUHAREKË**
OPSTINE SUVA REKA
THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA

19.08.2026

08 016 41605

**DREJTORIA PËR BUJQËSI, ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI**

**8-Nr.**

**Datë:19.08.2026**

## THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM TË FERMERËVE PËR PËRKRAHJEN E PRODHUESVE TË QUMËSHTIT PËR VITIN 2026

Njoftohen fermerët e Komunës së Suharekës se Drejtoria për Bujqësi ,Zhvillim Rural dhe Pylltari në kuader të programit për zhvillimin e bujqësis për vitin 2026 ,do të vazhdoj të mbështesë sektorin e blegtorisë Subvencionimit të qumështit nga **0.04 €** për liter për **gjashtëmujorin e pare për vitin 2026**

### Kriteret që duhet ti plotësojnë fermerët \aplikuesit:

1. Të jenë banorë të Komunës së Suharekës.
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Konfirmimin nga Banka për posedim të llogarisë aktive
4. Të jenë të regjistruar si fermerë në sistemin elektronik EFR-së –NIF dhe në sistemin e identifikimit të kafshëve në AUV.
5. Të kenë mbi 3 lopë qumështore.
6. Kontrata e nënshkruar nga qumështoret e licencuara.
7. Deshminë për sasin e dorëzuar të qumshtit në ndonjëren nga pikat grumbulluese të qumshtit apo qumështore të licencuara.
8. Të dorëzoj së paku 2000 ( dy mijë ) litra qumësht për gjashtëmujorin e parë të vitit 2026.
9. Subvencionimi vlen për fermerë që kanë të dorëzuar nga 2.000 (dymijë) deri në 30.000 (tridhjetë mijë ) litra qumësht në pikat grumbulluese.
10. Deklarata nën betim.

## Dokumentet e nevojshme për Aplikim

1. Kopja e letërnjoftimit.
2. Konfirmimin nga Banka për posedim të llogarise aktive.
3. Kontrata e nënshkruar nga qumështoret e licencuara.
4. Vërtetim për sasin e dorëzuar të qumështit në ndonjëren nga pikat e grumbullimit të qumështit apo qumështore të licencuara.
5. Kopja e listës së verifikimit të gjedheve të leshuar nga sektori për identifikimin dhe regjistrimin (I&R) në kuader të AUV-se.

**Kjo thirrje publike është e hapur për Aplikim prej Datës:18.08.2026 - 04.09.2026**

**Aplikacionet dorëzohen në zyrën Nr.1 Qendra për Shërbime të Qytetarëve**